

**VENDIM**  
**Nr. 203, datë 11.4.2018**

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE PËR PROKURORIN E PËRGJITHSHËM, NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t’i përcjellë menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare, si dhe t’ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë, në vazhdimësi, mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

**REKOMANDIME PRIORITARE**  
**PËR PROKURORIN E PËRGJITHSHËM**  
**NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2018**  
**TIRANË, MARS 2018**

**Hyrje**

Në zbatim të nenit 103, të ligjit nr. 97, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Ministrave miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm Rekomandimet Prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit. Ministri i Drejtësisë ua bën të njohura Rekomandimet e Këshillit të Ministrave, drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.

Ky është kuadri ligjor që determinon përgatitjen e këtij dokumenti, detyrim ky që lidhet me përgjegjësinë shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ndjekjen dhe realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë.

Këto rekomandime kanë për qëllim dhe synojnë marrjen e masave për të garantuar funksionimin efektiv të shtetit të së drejtës, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut, rekomandime të cilat jepen në ushtrim të përgjegjësisë shtetërore dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve.

Synimi i qeverisë shqiptare për këtë mandat qeverisës është jetësimi i reformës në drejtësi, me qëllim garantimin e një sistemi drejtësie të pavarur, eficient, të pakorruptuar, profesional dhe të aksesueshëm nga qytetarët.

1. Zbatimi i Reformës në Drejtësi ka filluar të japë rezultatet e para tashmë, vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit garantojnë ecurinë përpara të procesit të *Vetting*-ut, si dhe rikthejnë besimin te

qytetarët për pastrimin e sistemit të drejtësisë.

2. Në funksion të realizimit të këtij synimi qeveria mbështet dhe kërkon angazhimin maksimal të institucioneve ligjzbatuese, në marrjen e masave për reformimin e sistemit të drejtësisë, luftën kundër korrupsionit, goditjen e krimit të organizuar në të gjitha format e tij, intensifikimin e luftës kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar, në respekt të plotë të lirive dhe të drejtave të individit, barazinë e shtetasve përpara ligjit dhe angazhimeve të saj ndërkombëtare.

Përgatitja e këtyre rekomandimeve, është mbështetur në Programin Qeverisës 2017–2021<sup>1</sup>, si dhe në analizën e dokumenteve strategjike qeveritare, si: Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020<sup>2</sup>, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017–2020<sup>3</sup>, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020<sup>4</sup>, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015–2020<sup>5</sup>; Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2016–2020<sup>6</sup>, Plani i Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020<sup>7</sup>, por dhe në raportet e organizmave ndërkombëtarë joqeveritarë<sup>8</sup>, që lidhen me çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe trafikut të lëndëve narkotike.

Referuar nenit 6, pika 32, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ndryshuar me ligjin 40/2017, ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor Ministri i Drejtësisë i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion mbi zbatimin në vijimësi të rekomandimeve prioritare “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2017”, i cili është konsideruar në përgatitjen e këtyre rekomandimeve<sup>9</sup>.

Gjithashtu, në përgatitjen e këtyre rekomandimeve është shfrytëzuar edhe kontributi i paraqitur nga strukturat e pushtetit ekzekutiv, të cilat kanë në përbërje të tyre personel, që me ligj i është njohur cilësia e policisë gjyqësore, problematikat e konstatuara nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me organin e prokurorisë<sup>10</sup>, si dhe statistikën e dërguara nga organi i prokurorisë, në zbatim të nenit 38/germa “h”, të ligjit nr. 97/2016<sup>11</sup>.

Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave që duhen ndjekur për vitin 2018 nga organi i prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit do të vijojnë të jenë në drejtimit e mëposhtme:

### **Garantimi i pavarësisë të prokurorit**

Qëllimi i masave të ndërmarra nga qeveria shqiptare, në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës, është krijimi i një sistemi drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe eficient, sistem i cili duhet të jetë në gjendje të japë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe të zbatojë legjislacionin e përafuar me *Acquis* të BE-së.

Synimi i qeverisë shqiptare është krijimi i një sistemi ligjor plotësisht funksionues, efikas dhe efektiv që mbron të drejtat e qytetarëve, respekton shtetin ligjor, eliminon korrupsionin, si dhe mbron të drejtat e njeriut.

<sup>1</sup> Publikuar në faqen zyrtare: <https://kryeministria.al/al/programi/>

<sup>2</sup> Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM-ja 42, datë 25.1.2017 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 12/2017.

<sup>3</sup> Miratuar nga Këshilli i Ministrave, nr. 773, datë 2.11.2016 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare, datë 19 dhjetor 2017.

<sup>4</sup> Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM-së 348, datë 11.5.2016 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 86.

<sup>5</sup> Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM-së 247, datë 20.3.2015 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 47/2015.

<sup>6</sup> Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM-së 765, datë 2.11.2016 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 215/2016.

<sup>7</sup> Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM-së 248, datë 29.3.2017 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 65/2017

<sup>8</sup> Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “*International Narcotics Control Strategy Report - Money Laundering and Financial Crimes*”, mars 2018; Indeksi i Sundimit të Ligjit 2017–2018 i *World Justice Project* dhe Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2017, i *Transparency International* dhe raporti i *Amnesty International* për Shqipërinë 2017/2018.

<sup>9</sup> Ministria e Drejtësisë, me shkresat e saj nr. 1285/11, datë 21.9.2017 dhe nr. 1524, datë 2.2.2018, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2017. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 1162/2, datë 9.10.2017 dhe nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>10</sup> Ankesat e paraqitura nga qytetarët në formë shkresore në Ministrinë e Drejtësisë dhe në formë elektronike në platformat e komunikimit.

<sup>11</sup> Me shkresën nr. 2548, datë 27.2.2018.

3. Reforma në sektorin e drejtësisë synon forcimin e pavarësisë, llogaridhënies dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor. Kjo reformë është thelbësore për qeverinë shqiptare, e cila ka dhënë dhe do të vijojë të jap gjithë mbështetjen e nevojshme infrastrukturore dhe financiare për funksionimin optimal të organeve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

4. Në zbatim të kuadrit ligjor tashmë në fuqi, Prokuroria funksionon si një organ i decentralizuar duke garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj, nëpërmjet respektimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale, në përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe në plotësimin e funksioneve të tjera të dhëna me ligj. Kuadri i ri ligjor garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoriteti publik a privat.

5. Në kuadër të reformimit të rolit kushtetues të Prokurorisë dhe plotësimit të legjislacionit penal dhe procedural penal, gjatë vitit 2017 janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale<sup>12</sup>. Prokurori është përgjegjës për çështjen që i ngarkohet dhe i pavarur në punën e tij, me detyrimin në çdo rast të ndjekë udhëzimet e natyrës së përgjithshme të prokurorëve më të lartë, me qëllim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, bazuar edhe në rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit.

6. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i marsit 2018<sup>13</sup>, midis të tjerave ka përmendur se: *Qeveria ka ndërmarrë hapa për të luftuar korrupsionin e zyrtarëve, por duhet të vazhdojë të trajtojë korrupsionin në gjyqësor dhe prokurori. ... Korrupsioni gjyqësor, në veçanti, ka mbetur i lartë ... Pavarësisht akuzave të shpeshta, publike dhe, në shumë raste, të besueshme për korrupsion dhe veprimtari kriminale kundër zyrtarëve të nivelit të lartë në të gjithë spektrin politik, sistemi shqiptar i drejtësisë ka pak ndjekje të suksesshme ose dënime për korrupsion të nivelit të lartë.*

Lidhur me problemin e korrupsionit të sistemit gjyqësor, ai vazhdon të perceptohet se është i lartë. Sipas dokumentit “Indeksi i sundimit të ligjit 2017–2018” i *World Justice Project*<sup>14</sup>, i cili paraqet një pasqyrë të sundimit të ligjit në 113 vende, duke dhënë rezultatet dhe renditjen sipas vlerësimit nga 0 në 1. Në lidhje me vlerësimin sipas secilit faktor, për faktorin sistemi i drejtësisë penale, si një aspekt thelbësor për sundimin e ligjit, i cili përfshin të gjithë sistemin penal, Shqipëria është vlerësuar me 0,47 duke u renditur në vendin e 57-të në listë. Në lidhje me faktorin e dytë të vlerësimit - matja e mungesës së korrupsionit, Shqipëria ka një vlerësim prej 0,35 dhe renditet në vendin e 94-t. Në lidhje me nënkriteret për këtë faktor rezulton një vlerësim mjaft i ulët 0,32 për mungesën e korrupsionit në gjyqësor.

I njëjti perceptim rezulton edhe nga ankesat e paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë ku 7.2% e ankesave të paraqitura për periudhën shtator 2017- mars 2018, kanë për objekt korrupsionin në sistemin e drejtësisë<sup>15</sup>.

<sup>12</sup> Ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2018, hyrë në fuqi më 1.1.2018.

<sup>13</sup> Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, “*International Narcotics Control Strategy Report - Money Laundering and Financial Crimes*”, mars 2018, publikuar në faqen zyrtare: <https://www.state.gov/documents/organization/278759.pdf>

<sup>14</sup> *World Justice Project*, “Indeksi i sundimit të ligjit 2017–2018”, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendës dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen web: <https://worldjusticeproject.org/our-work/wjp-rule-law-index/wjp-rule-law-index-2017%E2%80%932018>; si dhe Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (*Corruption Perceptions Index - CPI* I Transparency International), i publikuar në faqen web: [https://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2017#table](https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017#table)

<sup>15</sup> Nga 766 ankesa të regjistruara, 55 prej tyre kanë për objekt korrupsionin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2017<sup>16</sup> në drejtim të garantimit të pavarësisë së prokurorit rezulton se nga ana e organit të prokurorisë: i) janë ndërmarrë veprime me qëllim përgatitjen e modeleve të akteve të reja, përditësimin, njohjen dhe zbatimin e drejtë të ndryshimeve ligjore; ii) Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzime dhe urdhra me qëllim rregullimin e organizimit të brendshëm dhe të shpërndarjes së çështjeve, në zbatim të nenit 53 të ligjit nr. 97/2016; iii) aktualisht Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar maksimalisht në dhënien e ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Në konsultim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit: ka ngritur grupin e punës për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit; ka miratuar formatin standard të raportit të vlerësimit; janë miratuar rregullat e reja për përzgjedhjen me short të pesë dosjeve për vlerësim; ka filluar procesi i vlerësimit të subjekteve prioritare: 3 anëtarët e KED-së, 19 kandidatët e KLP-së; është vijuar me shortin për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuesit e prokurorive të apelit dhe shkallëve të para. Deri në periudhën e dërgimit të informacionit<sup>17</sup> rezulton të jenë hedhur 48 shorte dhe janë dorëzuar raportet për 24 subjekte rivlerësimi; iv) janë organizuar sesione trajnimi nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me ndryshimet e reja ligjore;

Në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nga informacioni i organit të prokurorisë rezulton se nga sektori përkatës në Prokurorinë e Përgjithshme janë administruar 182 raste të reja, si dhe është vijuar me verifikimin e 323 rasteve të mbartura nga vitit 2016. Gjatë vitit 2017 janë marrë 437 vendime për këto subjekte. Por nuk rezulton se në sa nga 437 vendimet e marra është konkluduar se subjektet deklaruese kanë qenë në kushtet e ndalimit të funksionit aktual; në sa prej tyre janë regjistruar procedime penale për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, vepër penale kjo ekzistenca e së cilës lidhet me mosdeklarimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit dhe ecuria e këtyre procedimeve penale.

Nga të dhënat statistikore për vitin 2017<sup>18</sup> rezultojnë se për këtë periudhë janë vetëm 148 vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori, ose rreth 0,33% e numrit të përgjithshëm të çështjeve të regjistruara për këtë vit. Krahasuar me vitin e kaluar konstatohet një ulje e numrit të çështjeve kryesisht me 83 çështje më pak se në vitin 2016 dhe jo shtim i tyre siç është rekomanduar.

Në drejtim të forcimit të eficiencës dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve evidentohet se, për më tepër se një vit ka pushuar së ekzistuari Drejtoria e Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme, në kundërshtim kjo me dispozitat kalimtare të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilave është parashikuar se deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm heton shkeljet disiplinore nëpërmjet inspektorëve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Shkrija e kësaj strukture ndikoi negativisht edhe në procesin e rivlerësimit profesional të prokurorëve, detyrim ligjor ky i parashikuar në nenin 160/2, germa “d”, të ligjit nr. 96/2016. Gjithsesi kjo situatë tashmë është kthyer në normalitet me emërimin e Prokurores së Përgjithshme, e cila, në kuadër të riorganizimit të Prokurorisë së Përgjithshme, ka urdhëruar ngritjen e Sektorit të Hetimit Disiplinor<sup>19</sup>.

Sa më sipër, me qëllim forcimin dhe garantimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Angazhimin maksimal të Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim përshpejtimin e procesit të rivlerësimit profesional të prokurorëve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve;

ii) Forcimin e kapaciteteve profesionale të strukturës së verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, të Prokurorisë së Përgjithshme, në funksion të

<sup>16</sup> Ministria e Drejtësisë, me shkresat e saj nr. 1285/11, datë 21.9.2017 dhe nr. 1524 datë 2.2.2018 i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2017. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 1162/2, datë 9.10.2017 dhe nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>17</sup> Informacion i PP-së mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, dërguar me shkresën nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>18</sup> Të dërguara nga organi i prokurorisë në zbatim të nenit 38/germa “h”, të ligjit nr. 97/2016, me shkresën nr. 2548 datë 27.2.2018.

<sup>19</sup> 24 janar 2018, Prokurorja e Përgjithshme, Arta Marku, ka prezantuar strukturën e re të Prokurorisë së Përgjithshme ku përfshihet edhe ky sektor.

realizimit sa më efektiv të procesit të dekriminalizimit të funksionarëve publikë;

iii) Marrjen e masave për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve;

iv) Marrjen e masave për rritjen profesionale, me qëllim njohjen dhe zbatimin e drejtë të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, si dhe për specializimin e prokurorëve në funksion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal për të miturit, të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur;

v) Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

vi) Marrjen e masave për finalizimin e implementimit të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve edhe në prokuroritë e apeleve dhe Prokurorisë së Përgjithshme, duke reflektuar në të edhe ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, në funksion të realizimit të shortit elektronik të ndarjes së çështjeve.

### **Lufta kundër korrupsionit**

Lufta me tolerancë zero ndaj korrupsionit, sidomos korrupsionit në nivelet e larta dhe sekuestrimi e konfiskimi i të ardhurave me origjinë kriminale, aseteve kriminale apo pasurisë së pajustificuar të vënë nga korrupsioni zyrtar, është një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare, njëkohësisht edhe një nga kriteret që kushtëzon integritimin evropian të vendit.

Objektivat kryesorë të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2017–2020, në kuadër të luftës kundër korrupsionit janë: përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit; rritja e numrit të operacioneve ku përdoren teknika speciale të hetimit; rritja e hetimeve proaktive dhe rritja e kapaciteteve të strukturave të organeve ligjzbatuese; përdorimi dhe menaxhimi më i mirë i informacionit për hetimin e korrupsionit; forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit; garantimi i qëndrueshmërisë së oficerëve të policisë gjyqësore (OPGJ) dhe zyrtarëve të organeve ligjzbatuese; rritja e bashkëpunimit dhe e zhvillimit të takimeve dhe analizave me njësitë e përbashkëta hetimore (NJPH).

Zbatimi i reformës në drejtësi është një proces i rëndësishëm dhe me rol të padiskutueshëm në fushën e ndëshkimit të korrupsionit, në vlerësimin e gjyqtarëve, parandalimin e korrupsionit në gjyqësor, si dhe në hetimin e korrupsionit.

Siç edhe është cituar më sipër, Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i marsit 2018<sup>20</sup> midis të tjerave ka përmendur, se: ... *Pavarësisht akuzave të shpeshta, publike dhe, në shumë raste, të besueshme për korrupsion dhe veprimtari kriminale kundër zyrtarëve të nivelit të lartë në të gjithë spektrin politik, sistemi shqiptar i drejtësisë ka pak ndjekje të suksesshme ose dënime për korrupsion të nivelit të lartë ...*

**Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2017, në drejtim të luftës kundër korrupsionit organi i prokurorisë ka informuar<sup>21</sup>, se:** i) janë filluar kryesisht 12 procedime penale; ii) Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kryer hetime proaktive në kuadër të 11 procedimeve penale për vepra penale në sistemin e drejtësisë dhe të korrupsionit të funksionarëve të lartë shtetëror; iii) ka rritje të numrit të procedimeve penale të regjistruara, në 69,6% të numrit krahasuar me vitin 2016 dhe rritje të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim, në 80,8% më tepër në krahasim me vitin 2016<sup>22</sup>; iv) ka rritje me 40,3% të numrit të të pandehurve të regjistruar dhe rritje me 33,9% të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim<sup>23</sup>; v) vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” zë rreth 89% të veprave, por ky numër ka pësuar ulje rreth 4,4% krahasuar me vitin 2016; vi) është theksuar ashpërsimi i politikës penale për këtë kategori veprash penale, duke informuar se 74% janë kërkesë për arrest në burg; si dhe 60% janë kërkesë

<sup>20</sup> Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, “*International Narcotics Control Strategy Report - Money Laundering and Financial Crimes*”, mars 2018, publikuar në faqen zyrtare: <https://www.state.gov/documents/organization/278759.pdf>

<sup>21</sup> Ministria e Drejtësisë, me shkresat e saj nr. 1285/11, datë 21.9.2017 dhe nr. 1524, datë 2.2.2018, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2017. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 1162/2, datë 9.10.2017 dhe nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>22</sup> Nuk relatohen shifra por vetëm përqindje

<sup>23</sup> Nuk relatohen shifra por vetëm përqindje.

për dënim me burgim; vii) i është dhënë prioritet kallëzimeve penale të paraqitura nga ILDKPKI-ja, për 6 mujorin e parë të vitit 2017 janë regjistruar të gjitha rastet e kallëzuara - 15 raste dhe janë dërguar për gjykim 6 raste; viii) Lidhur me aksesin në bazat e të dhënave kombëtare dhe ndërlidhjes së sistemeve kompjuterike, është realizuar ndërlidhja me baza të dhënash shtetërore si tatimet, QKR, QKL, transportit rrugor dhe në proces është lidhja me sistemin e Policisë së Shtetit, është vijuar me implementimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori; ix) janë paraqitur statistika në lidhje me trajnimet vazhduese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës me objekt luftën kundër korrupsionit dhe numrin e prokurorëve pjesëmarrës në to, por mungojnë të dhënat në lidhje me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore.

Relatohet se për veprën penale të “refuzimit për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe i nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, e cila është vepër penale që referohet nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, numri i kallëzimeve penale të regjistruara për vitin 2017 është 20, po aq edhe numri i procedimeve penale të regjistruara. Ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 13.

Pra rezulton se jo të gjitha materialet referuese të dërguara nga ILDKPKI-ja dërgohen për gjykim, nuk relatohet numri i të pandehurve dërguar për gjykim dhe i atyre të organi i prokurorisë ka kërkuar dënimin, ndërkohë që për vitin 2017 është rekomanduar rritje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar me vendim të formës së prerë.

Nga të dhënat statistikore dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë nga organi i prokurorisë për vitin 2017<sup>24</sup> rezulton një situatë e tillë: janë regjistruar 1578 procedime penale për veprat penale në fushën e korrupsionit, me një numër total prej 398 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 332 persona.

Rezulton se ka një rritje të vogël të numrit të çështjeve të regjistruara me 52 çështje më tepër, por rezulton ulje e numrit të personave nën hetim krahasuar me vitin e kaluar. Gjithashtu ka një ulje prej 54 personash të marrë si të pandehur gjatë hetimit, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar<sup>25</sup>.

Rezulton se për vitin 2017 janë dërguar për gjykim vetëm 260 procedime penale ose rreth 16,5% të rasteve, me 315 të pandehur, krahasuar me vitin 2016<sup>26</sup>, është numër më i lartë çështjesh, por numër më i ulët të pandehurish.

Për vitin 2017 ka përfunduar gjykimi për 258 çështje penale (për veprat penale kundër korrupsionit) me një numër prej 337 të pandehurish, nga të janë dënuar 240 persona, krahasuar me vitin 2016<sup>27</sup> ka rritje të numrit me tre më tepër.

Sa më sipër nga të dhënat statistikore të vitit 2017 për veprat penale në fushën e korrupsionit evidentohet një tendencë në rritje e numrit të çështjeve të regjistruara, të dërguara për gjykim dhe numrit të personave të dënuar. Megjithatë, numri i çështjeve të dërguara për gjykim dhe i të dënuarve mbetet ende i vogël.

Në vitin 2017, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe të kallëzuara është 46 595, nga të cilat vetëm 148 janë vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori ose rreth 0,33% e numrit të përgjithshëm. Nga 148 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 46 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit ose rreth 31% e numrit të çështjeve, kryesisht, ku vendin kryesor e zë vepra penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, 34 çështje.

Pra, konstatohet një ulje prej 14 çështjesh krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara, kryesisht në 2016-en, ku kanë qenë regjistruar 60 çështje për vepra penale në fushën e korrupsionit, ndërkohë që për vitin 2017 është rekomanduar forcimi i rolit aktiv të prokurorit, sidomos në drejtim të rritjes të numrit të hetimeve proaktive.

<sup>24</sup> Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga organi i prokurorisë për vitin 2017 me shkresën datë 27.2.2018.

<sup>25</sup> Në 2016-en ishin 1526 çështje në hetim me 500 persona nën hetim dhe 386 të pandehur.

<sup>26</sup> Në vitin 2016 numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këto vepra ka qenë 212 procedime (13,9% e rasteve) me 371 të pandehur.

<sup>27</sup> Në vitin 2016 kishin përfunduar gjykimin 192 çështje penale me 312 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 237 persona.

Në informacionin e organit të prokurorisë<sup>28</sup> mungojnë të dhënat lidhur me hetimet financiare të kryera për veprat penale në fushën e korrupsionit, përgjatë vitit 2017.

Ndërsa, nga të dhënat statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë<sup>29</sup> rezulton se nga totali i çështjeve të filluara kryesisht për pastrimin e parave rezulton po i njëjti numër 3, por ndryshe nga viti 2016, 1 çështje është për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 287/1 i Kodit Penal dhe 2 çështje për veprën penale “Përvetësimi i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, neni 287/b i Kodit Penal<sup>30</sup>.

Pra mbetet një numër i vogël hetimesh pasurore që lidhen me veprën penale të korrupsionit, ndërkohë që për vitin 2017 është rekomanduar rritje e numrit të hetimeve proaktive dhe rritje e numrit dhe të cilësisë së hetimeve sidomos të rasteve të zyrtarëve të lartë publikë.

I njëjti konstatim vjen edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)<sup>31</sup> e cila informon se mbetet i ulët numri i rasteve të dërguara për gjykim për veprën penale të parashikuar 287 KP, krahasuar me numrin e çështjeve të regjistruara për këtë veprë.

Sa më sipër, me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

- i) Rritje të hetimeve proaktive dhe teknikave speciale të hetimit;
- ii) Kryerja e hetimeve sistematike pasurore dhe rritje e numrit të aseteve të sekuestruara që prej fazës fillestare të hetimit dhe konfiskimin e tyre në përfundim;
- iii) Hetime të shpejta dhe bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese;
- iv) Bashkëpunimi me agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare sidomos për kryerjen e hetimeve pasurore financiare që lidhen me veprat penale të korrupsionit;
- v) Përmirësimi i cilësisë së hetimeve të kryera me qëllim rritjen jo vetëm të personave të dërguar për gjykim por edhe rritje të personave të dënuar me vendim të formës së prerë;
- vi) Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit;
- vii) Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit;
- viii) Trajnime të oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët janë një hallkë shumë e rëndësishme e hetimeve;
- ix) Rritja e aksesit dhe përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore;
- x) Rritjen e cilësisë së mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore duke rritur profesionalizmin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit.

#### **Lufta kundër krimit të organizuar**

Lufta kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të paligjshme është një element shumë i rëndësishëm në përmbushjen e standardeve në kuadër të integritetit të Shqipërisë dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit. Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe organizatave kriminale, duke goditur çdo aset ekonomik të paligjshëm të tyre, është prioritet absolut i qeverisë.

Arritja e këtij objekti kërkon domos-doshmërisht konsolidimin e bashkëpunimit ndërkombëtar sidomos me agjencitë e specializuara në luftën kundër krimit të organizuar, shkëmbim të shpejtë të informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta në kuadër të efektivitetit të hetimit penal, mbrojtjen e të dhënave dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, përdorimin e metodave dhe të teknologjisë bashkëkohore, rritjen e profesionalizmit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Forcimi i reagimit të organeve ligjzbatuese është i domosdoshëm edhe në lidhje me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, në rastet e emigrimit, veçanërisht për kategori vulnerabel, si azilkërkuesit

<sup>28</sup> Dërguar me shkresën nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>29</sup> Me shkresën nr. 2548, datë 27.2.2018

<sup>30</sup> Për vitin 2016 ka qenë i njëjti numër por kanë qenë 2 çështje për veprën penale, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 287/1 i Kodit Penal dhe vetëm 11 çështje të filluara kryesisht për veprën penale, “Përvetësimi i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, neni 287/b i Kodit Penal.

<sup>31</sup> Me shkresën e saj nr. 143/1, datë 23.2.2018.

dhe personat e mitur të pashoqëruar.

Prioritet duhet të jetë forcimi i kapaciteteve dhe aftësive vepruese të agjencive të zbatimit të ligjit në hetimin financiar dhe garantimin e hetimit financiar si pjesë përbërëse e hetimit penal të përgjithshëm, identifikimi i sfidave dhe i mënyrës së adresimit të sistemeve informale të qarkullimit të parave, të cilat ndikojnë në mundësinë e pastrimit të produkteve të veprës penale<sup>32</sup>. Në këtë drejtim rekomandohet rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe hetimeve financiare për pastrimin e parave dhe trafikimin e drogës; si dhe rritja e konfiskimit të pasurisë së fituar në rrugë kriminale, me qëllim dobësimin e financave të grupeve të strukturuar kriminale.

Shqipëria tashmë ka një kuadër të plotë ligjor për konfiskimin e të ardhurave kriminale. Ligji nr. 70/2017, datë 27.4.2017 ka sjellë ndryshime në ligjin 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Një ndryshim thelbësor është ai e vendosjes së masave parandaluese mbi pasuritë e personave pa domosdoshmërinë e një dënimi penal përfundimtar, madje masat parandaluese mund të jepen edhe nëse vendimi përfundimtar nuk do të jepet<sup>33</sup>. Zbatimi i kuadrit ligjor dhe forcimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare, luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin dhe për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

**Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2017, në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar organi i prokurorisë ka informuar<sup>34</sup>, se:** i) prokuroritë e shkallës së parë, sidomos ajo e krimeve të rënda kanë zhvilluar takime dhe analiza të vazhdueshme me policinë e shtetit. Bashkëpunime intensive ka pasur edhe në nivel qendror veçanërisht në zbatimin e Planit Kombëtar kundër Kultivimit e Trafikimit të Kanabisit. Në muajin shkurt 2018 është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Brendshëm me qëllim forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, është hartuar udhëzimi nr. 1, datë 20.2.2018 i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për krijimin e seksioneve të posaçme”; ii) gjatë vitit 2017 janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet homologe ndërkombëtare Francë, Turqi; iii) Prokuroria e Krimeve të Rënda ka filluar procedime kryesisht për disa raste të narkotikëve të cilat janë evidentuar nga autoritetet e huaja. Për këto hetime janë zhvilluar takime dhe hetime të përbashkëta. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka filluar hetime në kuadër të disa procedimeve për grupe të strukturuar kriminale ku përfshihen edhe hetime proaktive të referuar, kryesisht nga Policia e Shtetit dhe raste të tjera për të cilat është marrë informacion nga strukturat e tjera ligjzbatuese; iv) për vitin 2017 janë regjistruar 17 procedime penale me 34 të pandehur për vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, 16 nga të cilat janë për nenin 333/a, grup i strukturuar kriminal. 8 procedime me 46 të pandehur janë dërguar në gjykatë dhe janë dënuar 30 të pandehur për këtë vepër penale. Në të gjitha rastet është kërkuar masë dënimi me burgim ku: 10% janë kërkesa për dënim të përjetshëm, 63.3% e maksimumin e dënimit, 13.3% kërkesa në marzhin e mesatares së dënimit dhe 13.4% kërkesa në minimumin e dënimit (kryesisht për të pandehurit që kanë bashkëpunuar në fazën e hetimit); v) për veprat penale në fushën e narkotikëve për vitin 2017 relatohet se ka rritje të procedimeve për nenin 283 të Kodit Penal nga 1034 në 1193, gjithashtu rritje në 51.3% të procedimeve të dërguara në gjykatë. Për veprën penale të kultivimit, neni 284 relatohet se ka ulje të procedimeve nga 1606 në 375 procedime. Për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, neni 283/a relatohet se numri i procedimeve të regjistruara është 196 që përbën rritje me 26.5% krahasuar me 2016, po ashtu edhe numri i procedimeve të dërguara në gjykatë 79 procedime ose 49% më shumë; vi) lidhur me hetimet pasurore, relatohet se Prokuroria e Krimeve të Rënda gjatë vitit 2017 ka paraqitur në gjykatë 4

<sup>32</sup> Konkluzione të seminarit rajonal, të zhvilluar në datat 19–20 shtator 2017, në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, nga OSBE-ja, IOM-ja dhe UNODC-ja, me temë: “Egja përpara në adresimin e krimeve të lidhura me migracionin në Evropën Juglindore.

<sup>33</sup> Sepse procedimi penalë pushohet apo subjekti është i pafajshëm për mungesë të provave.

<sup>34</sup> Ministria e Drejtësisë, me shkresat e saj nr. 1285/11, datë 21.9.2017 dhe nr. 1524, datë 2.2.2018, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2017. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 1162/2, datë 9.10.2017 dhe nr. 1162/4, datë 21.2.2018

kërkesa për sekuestrim pasurie dhe 7 kërkesa për konfiskim të pasurive, ku pasuritë kanë qenë apartamente, truall, llogari bankare në vlerë të disa milionë eurove; vii) lidhur me pastrimin e parave relatohet se gjatë vitit 2017 krahas rritjes së numrit të procedimeve penale të regjistruara, është rritur edhe numri i procedimeve të dërguara në gjykatë. Janë regjistruar 320 procedime dhe janë dërguar në gjykim 36 procedime për nenet 287, 287/a, 87/b të Kodit Penal. Peshën kryesore 96.6% në këto vepra e zë vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Procedimet e regjistruara për vitin 2017 për këtë veprë rezultojnë se janë rritur prej 36% në krahasim me 2016. Po ashtu, rritje ka edhe numri i të pandehurve të dërguara në gjykatë nga 8 në 31 procedime; ix) lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale relatohet se janë zhvilluar seminare me projektin PAMECA V, Shkollën e Magjistraturës, OPDAT, lidhur me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, ndryshimet e reja të ligjit antimafia, trafikimin e qenieve njerëzore, por mungojnë të dhënat në lidhje me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i marsit 2018<sup>35</sup>, midis të tjerave ka përmendur se: *Ndonëse ka arrestime dhe ndjekje penale të vazhdueshme për ata që marrin pjesë në trafikun e drogës, ka pasur pak ndjekje penale të atyre që menaxhojnë, organizojnë trafikimin ose që përfitojnë politikisht apo financiarisht nga mbështetja e figurave të krimit të organizuar. ... Numri i konfiskimeve dhe i arrestimeve të drogës është rritur ndjeshëm brenda vendit gjatë viteve të fundit ... Pasuritë e patundshme (veçanërisht në zonat bregdetare), projektet e zhvillimit të biznesit dhe lojërat janë ndër metodat më të njohura të fshehjes së të ardhurave të paligjshme. Zbatimi i ligjit njëh nevojën për të luftuar pastrimin e parave, .... Nevojitet një bashkëpunim më i mirë ndërmjet policisë dhe prokurorëve ... Disa, por jo të gjitha, gjykatat shqiptare kërkojnë ekzistencën e një veprë paralele para se të lëshohet një dënim për pastrimin e parave, edhe pse ligji në mënyrë specifike deklaron se nuk është e nevojshme ekzistenca e një veprë mëmë. Në vitin 2017, ligji i konfiskimit antimafia u ndryshua për të adresuar kufizimet e mëparshme. Në mënyrë të veçantë, ligji i ndryshuar ka shtuar dispozita për konfiskimin e pasurisë dhe juridiksionin e decentralizuar të konfiskimit, duke u mundësuar prokurorëve të rrethëve që të ndjekin konfiskimin e pasurisë lidhur me hetimet penale. Përkundër ndryshimeve në ligj, për të rritur aftësinë e prokurorëve për të hetuar dhe konfiskuar pasuritë që lidhen me të ardhurat kriminale, mangësitë mbesin në lidhje me zbatimin e ligjit.*

Nga të dhënat statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë për vitin 2017<sup>36</sup>, lidhur me veprat penale të krimit të organizuar rezultojnë se janë hetuar 3067 çështje penale ose 1014 çështje penale më pak se viti 2016. Janë dërguar për gjykim 809 çështje ose 26,4% e çështjeve me 1126 të pandehur<sup>37</sup>. Janë hetuar 1352 persona dhe janë marrë të pandehur 1295 persona. Krahasuar me vitin 2016 rezultojnë 173 persona më pak të hetuar por 33 persona më tepër të marrë të pandehur.

Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e zënë veprat penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” neni 283 i Kodit Penal me 1680 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 596 çështje; “Kultivimi i bimëve narkotike”, neni 284 i Kodit Penal, me 1023 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 134 çështje.

Lidhur me veprat penale të trafikimit<sup>38</sup>, rezultojnë se janë regjistruar 221 çështje penale me 42 persona në hetim, nga të cilët 12 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 22 çështje me 28 të pandehur ose rreth 10% e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të hetuara e zë vepra penale, “Trafikimi i mjeteve motorike” me 142 çështje të regjistruara.

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 16 çështje për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal” neni 333/a i Kodit Penal dhe 1 çështje për veprën penale, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” neni 334 i Kodit Penal. Për këto vepra penale, gjatë vitit 2017 janë dërguar për gjykim 8 çështje, ku 1 çështje është dërguar për veprën penale “Organizata kriminale” neni 333 i Kodit Penal me 1 të pandehur dhe 7 çështje për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, neni 333/a i Kodit Penal, me 45 të pandehur.

<sup>35</sup> Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, “International Narcotics Control Strategy Report- Money Laundering and Financial Crimes”, mars 2018, publikuar në faqen zyrtare: <https://www.state.gov/documents/organization/278759.pdf>

<sup>36</sup> Dërguar me shkresën nr. 2548, datë 27.2.2018.

<sup>37</sup> Krahasuar me të dhënat e vitit 2016, rezultojnë rritje prej 74 çështjesh për gjykim dhe 69 të pandehur më tepër.

<sup>38</sup> Nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a dhe 282/a të Kodit Penal.

Lidhur me veprat penale me natyrë terroriste, rezulton se janë regjistruar në total 7 çështje për vitin 2017, nga të cilat 1 çështje për veprën penale, “Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera”, neni 111 i Kodit Penal; 1 çështje për veprën, “Vepra me qëllime terroriste”, neni 230 i Kodit Penal; 3 çështje për veprën, “Financimi i terrorizmit” parashikuar nga neni 230/a; 1 çështje për veprën, “Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin” neni 230/b i Kodit Penal dhe 1 çështje për veprën, “Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste” neni 232 i Kodit Penal. Për këto çështje të regjistruara nuk ka persona në hetim dhe as persona të marrë në cilësinë e të pandehurit. Nuk rezulton asnjë çështje e dërguar për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2017, megjithatë krahasuar me vitin 2016, vihet re një rritje e numrit të çështjeve të regjistruara<sup>39</sup>.

Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura<sup>40</sup> për vitin 2017 janë regjistruar 9 çështje penale për veprën penale, “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve” parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal me 1 person të marrë si të pandehur. Për vitin 2017 është dërguar për gjykim 1 çështje po për këtë veprë penale me 1 të pandehur.

Në informacionin e organit të prokurorisë<sup>41</sup> mungojnë të dhënat lidhur me numrin e hetimeve proaktive për veprat penale të krimit të organizuar përgjatë vitit 2017, është përmendur vetëm se Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kryer të tilla. Ndërsa nga të dhënat statistikore të dërguara nga organi i prokurorisë<sup>42</sup> rezulton se për këtë kategori veprash penale janë 9 procedime të filluara kryesisht nga të cilat 6 lidhen me veprën penale të trafikimit të narkotikëve; 1 për grup të strukturuar kriminal; 1 për trafikim të njerëzve dhe 1 për trafikim të lëndëve plasëse.

Në informacionin e organit të prokurorisë<sup>43</sup> mungojnë të dhënat lidhur me veprat penale kompjuterike. Të dhënat statistikore në lidhje me veprat penale në fushën kompjuterike<sup>44</sup> flasin për një numër të ulët çështjesh të regjistruara për vitin 2017, vetëm 140 çështje të regjistruara, ndërkohë që numri i çështjeve të dërguara për gjykim është shumë më i ulët, 4 çështje. Për këto vepra penale për vitin 2017 rezulton se janë dënuar 6 persona.

Sa më sipër, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Forcim të bashkëpunimit me policinë gjyqësore dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, me qëllim shkëmbimin e informacionit, kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta, me qëllim rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj grupeve të strukturuar kriminale;

ii) Hetime sistematike pasurore dhe rritje të numrit të aseteve të konfiskuara, në zbatim të ligjit 10192/2009, ndryshuar me ligjin 70/2017, specifikisht në drejtim të masave parandaluese;

iii) Rritje të numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave, në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim;

iv) Rritjen e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për grupet e strukturuar kriminale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, në rastet e emigrimit, veçanërisht për kategori vulnerabël si azilkërkuesit dhe personat e mitur të pashoqëruar;

v) Rritje të numrit dhe të cilësisë së hetimeve duke përdorur teknikat speciale të hetimit;

vi) Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit;

vii) Forcim të kapaciteteve profesionale të prokurorëve, por edhe të oficerëve të policisë gjyqësore;

<sup>39</sup> Në vitin 2016 janë regjistruar vetëm dy çështje për këto vepra: 1 për nenin 230 dhe 1 për nenin 234 të Kodit Penal.

<sup>40</sup> Nenet 265–265/c të Kodit Penal.

<sup>41</sup> Dërguar me shkresën nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>42</sup> Me shkresën nr. 2548, datë 27.2.2018.

<sup>43</sup> Dërguar me shkresën nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>44</sup> Veprat penale të parashikuara nga nenet 74/a, 84/a, 119/a, 119/b, 137/a, 143/b, 186/a, 192/b, 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç të Kodit Penal.

viii) Rritja e aksesit dhe e përdorimit të të dhënave në databazat shtetërore, në funksion të shpejtësisë dhe efektivitetit të së hetimeve;

ix) Rritjen e cilësisë së mbajtjes dhe raportimit të të dhënave statistikore duke rritur profesionalizmin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit.

### **Të drejtat e njeriut**

Qeveria shqiptare është e angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për të zbatuar më tej politikat e antidiskriminimit, përmirësimin e gjendjes me të drejtat sociale, me fokus të veçantë te grupet vulnerabël dhe të miturit. Po ashtu Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016–2020 në kuadër të synimit për qeverisje të mirë, garantimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, parashikon reformimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë dhe cilëson sistemin e drejtësisë për të miturit si një sfidë të rëndësishme.

Qeveria ka vlerësuar maksimalisht edhe fenomenin e dhunës në familje, duke e referuar atë si objektiv në programin qeverisës të saj 2017–2021, nëpërmjet programeve, iniciativave dhe strategjive për adresimin më të mirë të rasteve të dhunës në familje.

7. Në këtë kuadër, reforma në drejtësi ka përmirësuar dukshëm legjislacionin penal lidhur me të drejtat e viktimës dhe të fëmijëve në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor për të miturit dhe gratë viktimë të dhunës në familje.

8. Ligji nr. 35/2017<sup>45</sup>, i cili parashikon ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, synon ta përafrojë legjislacionin procedural penal me standardet më të mira ndërkombëtare të parashikuara nga instrumentet ndërkombëtare në të cilat shteti shqiptar bën pjesë dhe synon të aderojë, si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata e Drejtësisë, *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, etj., Këto ndryshime kanë përcaktuar konceptin e “viktimës” dhe “viktimës akuzuese”, duke shtuar figura të posaçme “viktimën e mitur” dhe “viktimën e abuzuar seksualisht apo subjekt të trafikimit”; si dhe duke dhënë dhe përkufizimet dhe rregullimet për këto subjekte, duke plotësuar dhe të drejtat e tyre në përputhje me vendimin kuadër të 15 marsit 2001 mbi qëndrimin e viktimave në procedimet penale, zëvendësuar më tej nga direktiva 2012/29/BE.

9. Kuadri ligjor për të miturit është plotësuar me ligjin nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë për të Mitur”, i cili ka për qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit, integrimin social të tyre, rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të të miturve dëshmitarë dhe viktimë, parandalimin e viktimizimit dytë (riviktimizimit), parandalimi në kryerjen e veprës penale dhe sigurimi i rendit publik gjatë administrimit të drejtësisë. Kodi i Drejtësisë për të Mitur parashikon norma specifike procedurale për organet përgjegjëse gjatë procedurës së administrimit të drejtësisë; norma specifike procedurale që duhet të respektohen në proceset penale që afektojnë fëmijët, si dhe rregulla të posaçme për ekzekutimin e vendimeve dhe masa të tjera alternative. Interesi më i lartë i të miturit është një parim i rëndësishëm i cili duhet të gjejë zbatim pikë së pari në të drejtën penale.

10.

11. Të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël, ndaj edhe mbrojtja e tyre përbën një ndër objektivat strategjike më të rëndësishëm të reformës në sistemin e drejtësisë penale. Garantimi i drejtësisë miqësore dhe realizimi i interesit më të lartë të fëmijës është qëllimi i ndryshimeve ligjore dhe synimi që kërkohet të realizohet.

Me qëllim garantimin e të drejtave të të gjitha subjekteve të procedimit penal, me fokus të miturit dhe viktimat e dhunës në familje, si një garanci e shtuar lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjatë procesit penal, është e domosdoshme që këto ndryshime të rëndësishme ligjore të njihen dhe të zbatohen nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Është e nevojshme rritja e

---

<sup>45</sup> Hyrë në fuqi në datën 1.8.2017.

profesionalizmit nëpërmjet trajnimeve specifike dhe përmbushja e detyrimeve ligjore prej tyre nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjit.

12. Sipas dokumentit “Indeksi i sundimit të ligjit 2017–2018” i *World Justice Project*,<sup>46</sup> i cili paraqet një pasqyrë të sundimit të ligjit në 113 vende, duke dhënë rezultatet dhe renditjen sipas vlerësimit nga 0 në 1, lidhur me faktorin e katërt të vlerësimit, që lidhet me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, *Shqipëria ka një vlerësim të përgjithshëm prej 0,63 dhe renditet në vendin e 41-të në renditjen e përgjithshme.*

Sipas raportit të *Amnesty International* për vitin 2017 për Shqipërinë<sup>47</sup> *përmendet se masat për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje nuk janë zbatuar në mënyrë adekuate, duke përmendur rastin e gjyqtarës, që humbi jetën dhe mungesën e mbrojtjes së ofruar nga shteti ndaj saj; si dhe përmend raste trafikimit të grave dhe të miturve për prostitucion dhe punë të detyruar.*

**Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2017<sup>48</sup> në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, rezulton se nga ana e organit të prokurorisë: i)** relatohen të dhënat statistikore lidhur me numrin e procedimeve për veprat penale ndaj fëmijëve dhe familjes, të ndara sipas kategorive të veprave penale; si dhe numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, nga të cilat ka rezultuar një rritje prej 34,4% e procedimeve të regjistruara për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit” parashikuar nga neni 124/b. Relatohet se ka qenë prioritet hetimi i shpejtë i këtyre rasteve, por nuk relatohet se sa ka qene afati i hetimit të tyre. Relatohet se ka një numër ende të lartë të veprave penale ndaj familjes dhe fëmijëve; ii) në lidhje me veprat ndaj familjes janë paraqitur të dhënat statistikore lidhur me ashpërsimin e dënimit, në lidhje me veprën penale të vrasjes për shkak të rrethanave familjare, por nga të dhënat e paraqitura rezulton një ulje e numrit në 25 procedime, krahasuar me 26 procedime në 2016; iv) relatohet për trajnimet e kryera në periudhën parazgjedhore të prokurorëve, me qëllim zbatimin e legjislacionit të ri penal lidhur me veprat penale në fushën e zgjedhjeve. Janë paraqitur të dhëna statistikore për numrin e procedimeve të regjistruara sipas veprave penale, ku rezulton vetëm 1 procedim i dërguar për gjykim për veprën penale, “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal; v) relatohet se në zbatim të ndryshimeve ligjore - hyrjes në fuqi të ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”, me qëllim zbatimin me sukses dhe rritjen e kapaciteteve të strukturave përkatëse, në janar 2018 është krijuar në Prokurorinë e Përgjithshme një strukturë e posaçme me prokurorë dhe psikologë, ndërsa mbetet i nevojshëm shtimi i kapaciteteve njerëzore; vi) gjithashtu, në këtë drejtim është përmendur bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe projektin e Mbretërisë së Suedisë, me qëllim rritjen e kapaciteteve për përmbushjen e standardeve të drejtësisë për të mitur;

Nga të dhënat statistikore për vitin 2017<sup>49</sup> konstatohet se për vitin 2017 në lidhje me veprën penale, “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, janë regjistruar 1310 çështje penale ose rreth 4,2% e të gjitha çështjeve penale të regjistruara<sup>50</sup>, me 327 persona nën hetim. Për këto çështje janë marrë në cilësinë e të pandehurit 952 persona.

Rezulton se janë dërguar për gjykim 1057 çështje për këtë vepër penale, me total prej 1074 të pandehurish ose rreth 9,2% e të gjitha çështjeve të dërguara për gjykim<sup>51</sup>. Krahasuar me vitin 2016

<sup>46</sup> *World Justice Project*, “Indeksi i sundimit të ligjit 2017–2018”, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendës dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen *web*: <https://worldjusticeproject.org/our-work/wjp-rule-law-index/wjp-rule-law-index-2017%E2%80%932018>; si dhe Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (*Corruption Perceptions Index - CPI I Transparency International*), i publikuar në faqen *web*: [https://www.transparency.org/news/feature/corruption\\_perceptions\\_index\\_2017#table](https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017#table)

<sup>47</sup> Publikuar në faqen *web*: <https://www.amnesty.org/en/countries/europe-and-central-asia/albania/report-albania/>

<sup>48</sup> Ministria e Drejtësisë, me shkresat e saj nr. 1285/11, datë 21.9.2017 dhe nr. 1524, datë 2.2.2018, i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm informacion lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2017. Prokuroria e Përgjithshme ka informuar me shkresat e saj nr. 1162/2, datë 9.10.2017 dhe nr. 1162/4, datë 21.2.2018.

<sup>49</sup> Të dërguara nga organi i prokurorisë në zbatim të nenit 38/germa “h”, të ligjit nr. 97/2016, me shkresën nr. 2548, datë 27.2.2018.

<sup>50</sup> Për vitin 2017 janë regjistruar në total 31462 çështje pa përfshirë çështjet e mbartura.

<sup>51</sup> Për vitin 2017 janë dërguar për gjykim 11492 çështje pa përfshirë çështjet e mbartura.

konstatohet një numër më i ulët i çështjeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim<sup>52</sup>. Nga këto çështje për vitin 2017 janë gjykuar 953 çështje me 1011 të pandehur.

Lidhur me politikën e dënimit, të ndjekur gjatë gjykimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria, vetëm për 9 të pandehur është kërkuar dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës i dispozitës (krahësuar me 17 raste të vitit 2016), ndërsa: i) për 1 rast është kërkuar dënimi sa masa e paraburgimit; ii) për 166 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita<sup>53</sup>; iii) për 343 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit<sup>54</sup>; dhe iv) për 3 të pandehur për paragrafin e katërt të dispozitës është kërkuar dënimi me gjobë. Ndërkohë, që për vitin 2017 është rekomanduar ashpërsim i politikës së dënimit për rastet e dhunës në familje.

Me ligjin nr. 89/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i cili hyri në fuqi menjëherë në datën 23.5.2017, u bënë disa ndryshime në pjesën e dispozitave penale për veprat penale në fushën e zgjedhjeve<sup>55</sup>.

Nga analiza e statistikave rezulton se për vitin 2017, për këto vepra penale janë regjistruar 80 çështje penale me 87 persona nën hetim, nga të cilët 12 janë marrë në cilësinë e të pandehurit. Nga këto çështje një numër i vogël, vetëm 10 ose 12,5% e numrit të çështjeve të regjistruara është dërguar për gjykim, me një numër prej 12 të pandehurish. Ndërkohë, që për vitin 2017 është rekomanduar: hetime të shpejta efektive dhe ashpërsim dënimi për veprat penale në fushën e zgjedhjeve.

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjykimi i drejtpërdrejtë vijon të mbetet një nga llojet e gjyqimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë. Organi i prokurorisë për vitin 2017 ka dërguar për gjykim 11 492 çështje (nuk përfshihen çështjet e mbartura në gjykim), por vetëm për 708 prej tyre ka kërkuar që të gjykohej me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë ose me rreth 6,1%. Rezulton një ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2016<sup>56</sup> dhe një ulje e çështjeve për të cilat është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë. Ndërkohë, që për vitin 2017 është rekomanduar rritje e rasteve të kërkuara nga organi i prokurorisë për gjykimin e drejtpërdrejtë.

Bazuar në konstatimet e sipërcituara dhe parashikimet e reja ligjore, me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut të subjekteve të procedimit penal, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Zbatimin e kuadrit të ri ligjor lidhur me drejtësinë për të mitur në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor, aplikimit të masave alternative të shmangies nga ndjekja penale;

ii) Hetime të shpejta dhe respektim të të drejtave dhe garancive procedurale si në drejtim të të miturit në konflikt me ligjin, të mitur dëshmitar dhe viktimat të veprës penale;

iii) Përmirësimi i aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e çështjeve që lidhen me drejtësinë penale për të mitur;

iv) Hetime të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës së dënimit për veprat penale të dhunës në familje;

v) Zbatimin e kuadrit të ri ligjor në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor për viktimat e veprës penale në përgjithësi dhe në veçanti për viktimat e dhunës në familje;

#### **Bashkëpunimi ndërinstitucional**

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kërkon domosdoshmërisht koordinimin ndërinstitucional midis organit të prokurorisë dhe të gjitha institucioneve dhe agjencive të tjera ligjzbatuese. Shkëmbimi i shpejtë i informacionit dhe kryerja e operacioneve të përbashkëta ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj grupeve të strukturuar kriminale.

<sup>52</sup> Për vitin 2016 janë regjistruar 1614 çështje me 421 persona nën hetim dhe 1271 persona, në cilësinë e të pandehurit gjatë hetimeve, nga të cilat janë dërguar për gjykim 1157 çështje.

<sup>53</sup> Në vitin 2016, dënimi minimal është kërkuar për 251 të pandehur.

<sup>54</sup> Në vitin 2016, pezullimi i ekzekutimit është kërkuar për 261 të pandehur.

<sup>55</sup> Konkretisht u ndryshuan dhe u shtuan dispozita në nenet 327–332/a,

<sup>56</sup> Për vitin 2016 janë dërguar për gjykim 12997 çështje, për 1241 prej të cilave është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë.

Bashkëpunimi i organeve të hetimit me ILDKPKI-në, KLSH-në, DPPP-në, ZRPP-në apo edhe subjekteve private, të tilla si: bankat, firmat e ndërtimit, agjencitë e pasurive të paluajtshme, agjencive turistike etj. është një parakusht për suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Shumë i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi ndërkombëtar me agjencitë analoge, sidomos për veprat penale të terrorizmit, krimit të organizuar, krimit ndërkufitar, parandalimin e krimeve kompjuterike, të përdorura për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe ato për financimin e terrorizmit, si dhe bashkëpunimet e posaçme për personat që i fshihen drejtësisë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar konsiderohet si një prioritet tjetër i rëndësishëm për suksesin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, shkëmbimi i informacionit dhe i përvojës, organizimi i operacioneve të përbashkëta dhe mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët janë drejtime të rëndësishme për t'u ndjekur.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, një fushë me rëndësi të veçantë përfshin marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale. Para së gjithash, bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë kërkon fillimisht koordinimin ndërinstitucional midis organit të prokurorisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese apo institucioneve të tjera që marrin pjesë aktive në proces.

13. Shqipëria ka një kuadër plotë ligjor në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me shtetet e huaja. Ligji nr. 10193/2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", përcakton standarde bashkëkohore për sa i përket forcimit të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare, për përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e procedurave të shkëmbimit të informacionit apo dokumenteve.

14. Rëndësi të veçantë në këtë fushë ka instituti i ekstradimit. Ky institut gjen rregullim në Konventën e Këshillit të Evropës, "Për ekstradimin" dhe të protokolleve shtesë të saj, aderuar nga ana e Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, në ligjin nr. 10139/2009, si dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

15. Me qëllim garantimin e të drejtave të të gjitha subjekteve të procedimit penal, në çështjet që kanë për objekt ekstradimin, si një garanci e shtuar lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjatë procesit penal, është e domosdoshme dhe e nevojshme rritja e koordinimit dhe e bashkëpunimit midis organeve ligjzbatuese dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Pavarësisht bashkëpunimit të vazhdueshëm, shihet e nevojshme përmirësimi i disa procedurave, me qëllim rritjen e efektivitetit.

**Lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2017 në drejtim të bashkëpunimit ndërinstitucional,** raportohet për një bashkëpunim kryesisht me Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit<sup>57</sup>, si dhe për një udhëzim të përbashkët midis ministrit të Brendshëm, ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Shëndetësisë<sup>58</sup>. Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar raportohet për skuadra të përbashkëta hetimore kryesisht me Italinë, konferencën e organizuar në Shqipëria nga prokuroria shqiptare<sup>59</sup>, po ashtu gjatë vitit 2017 janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet homologe ndërkombëtare: Francë, Turqi, bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, projektin IPA 2014, projektin PAMECA VI.

Problematikat e paraqitura nga ministritë e linjës që kanë në kompetencë agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, evidentojnë edhe më dukshëm nevojën e rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, si një premisë bazë për suksesin e veprimtarisë së organit të prokurorisë lidhur me hetimin dhe goditjen e kriminalitetit. Nga analiza e problematikës të paraqitura nga ministritë përkatëse ka rezultuar se:

<sup>57</sup> Marrëveshja nr. 986/1, datë 29.6.2017, në kuadër të luftës kundër kanabisit; marrëveshja e shkurtit 2018, në kuadër të në funksion të Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar; Marrëveshja e bashkëpunimit për shkëmbenim e informacionit nëpërmjet sistemit të menaxhimit policor të çështjes dhe sistemit të menaxhimit të çështjes së prokurorisë.

<sup>58</sup> Udhëzimi i përbashkët nr. 2487, datë 15.5.2017.

<sup>59</sup> 22–24 maj 2017, Konferenca e 16-të Evropiane Rajonale e Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit<sup>60</sup> bën me dije se nga 47 materiale referuese të ISHMPU vetëm 5 prej tyre janë dërguar për gjykim. Është rekomanduar: i) Forcimi i bashkëpunimit me strukturat në nivel qendror dhe rajonal të ISHMU me prokuroritë, për rritjen e cilësisë së hetimit dhe referimin e saktë të veprës penale, mbledhjen e provave dhe evidentimin e përgjegjësisë penale; ii) Zhvillimi i trajnimeve të përbashkëta midis inspektorëve të ISHMU në nivel qendror/rajonal dhe prokurorëve të rretheve gjyqësore; iii) Forcimi i masave ndëshkuese nga prokuroria për kundërvajtjet penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit apo përbërësve të tij të veçantë.

E njëjta situatë rezulton edhe nga analiza e të dhënave statistikore të organit të prokurorisë. Për vitin 2017 për veprat penale të drejtura ndaj mjedisit (nenet 201–207 të Kodit Penal), janë regjistruar vetëm 216 çështje, ose 59 çështje më pak se viti 2016. Nga këto çështje vetëm 45 ose rreth 21% e numrit të çështjeve janë dërguar për gjykim me një numër prej 56 të pandehurish, shifra më të ulëta se të vitit 2016<sup>61</sup>. Ndërkohë që për këto vepra për vitin 2017 është rekomanduar hetime të shpejta dhe ashpërsim të dënimit.

Ministria e Brendshme<sup>62</sup>, lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional bën me dije se bashkëpunimi me organin e prokurorisë nuk ka qenë në nivelet e shprehura në pjesën më të madhe të vitit 2017, pasi puna e përbashkët hetimore nuk ka plotësuar nevojat për një rritje cilësore të luftës kundër krimit. Kjo situatë ka filluar të ndryshojë pozitivisht gjatë muajve të fundit të vitit 2017 dhe përmirësim më i dukshëm në muajt e parë të vitit 2018 dhe rritja e cilësisë së bashkëpunimit ka sjellë edhe finalizimin e disa hetimeve të suksesshme në kuadër të operacionit forca e ligjit, si dhe në kuadër të hetimeve të tjera të strukturave të Policisë së Shtetit me iniciativë të tyre ose në vijim të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në këtë kuadër rekomandohet<sup>63</sup>: i) të forcohet bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorisë, si dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, me qëllim zbulimin efektiv të rrjeteve kriminale, identifikimin e anëtarëve dhe aseteve në dispozicion të tyre; ii) të informohet Policia e Shtetit për rastet e përfundimit të hetimeve për dënimet apo pushimin e procedimeve për veprat penale të referuara nga vetë policia; iii) të forcohet bashkëpunimi dypalësh, por edhe me institucionet e tjera ligjzbatuese me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve hetimore, në kohë reale dhe me eficiencë, për ndjekjen dhe ndëshkrimin e fenomeneve korruptive; iv) zhvillimi periodik i analizave të përbashkëta të procedimeve penale, me qëllim evidentimin e praktikave të mira dhe problemeve të hasura; v) organizimi i trajnimeve të përbashkëta midis prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, me asistencë ndërkombëtare; vi) krijimi i strukturave të përbashkëta hetimore me oficerë të specializuar në tipologji të veçanta krimesh.

Ministria e Brendshme bën me dije edhe disa çështje të tjera adresimi i të cilave i shërben rritjes së efektivitetit të hetimeve dhe konkretisht sillet në vëmendje se: i) rastet e shpalljes së moskompetencës për referimet e marra, kur prokuroria i kthen materialet sërish në Policinë e Shtetit, sjell vonesë në trajtimin e rastit; ii) ruajtja e sendeve të sekuestruara, sidomos në sasi të mëdha, kur bëhet fjalë për procedime për kultivim apo trafikim narkotikësh deri në përfundim të procedimit penal përkatës, krijon vështirësi për magazinimin dhe sigurinë e ruajtjes së tyre, në këtë aspekt bëhet me dije se po punohet për udhëzimin specifik në zbatim të nenit 215 të Kodit të Procedurës Penale; iii) në lidhje me përgjimet parandaluese, të kërkuara nga strukturat vendore të policisë së shtetit, prokuroria vazhdon të caktojë pika kontakti në strukturat qendrore, e cila shton një hallkë të panevojshme komunikimi, që mund të sjellë vonesa.

<sup>60</sup> Me shkresën e saj nr. 995/1, datë 1.3.2018, informon se për vitin 2017 ka depozituar në organin e prokurorisë 47 kallëzime penale për vepra penale që lidhen me mjedisin. Rezulton se për 40 kallëzime prokuroria ka vendosur mosfillimin, pezullimin, pushimin e hetimeve<sup>60</sup> dhe vetëm për 5 prej tyre është vendosur dërgimi në gjyq, 2 kallëzime kanë qenë në proces.

<sup>61</sup> Në vitin 2016 janë dërguar për gjykim 58 çështje me 72 të pandehur.

<sup>62</sup> Me shkresën e saj nr. 989/2, datë 26.3.2018.

<sup>63</sup> Përveç rekomandimeve në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të cilat janë përfshirë në materialin dhe rekomandimet e cituara në pjesët e tjera të këtij materiali.

Për këto konstatime teknike Ministria e Brendshme rekomandon marrjen e masave për: i) kalimin e drejtpërdrejtë të referimit në prokurorinë kompetente, për të evituar vonesat në rast kthimi në strukturat e policisë; ii) normimin nga organi i prokurorisë të çështjes së asgjësimit të sendeve të sekuestruara, duke ruajtur kampionë për procedimet penale në vazhdim; iii) caktimin si pika kontakti strukturat vendore të policisë së qarkut që kanë bërë kërkesat për përgjim, ndërsa transkriptet e bëra nga struktura e përgjimit, t'i dërgohen sektorit në qendër, me qëllim një koordinim më të mirë të punës dhe reagim më të shpejtë për parandalimin e ngjarjeve kriminale.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë<sup>64</sup>, lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional sugjeron:

i) forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimit me qëllim ndëshkimin e veprave penale në fushën e pastrimit të parave/taksave dhe tatimeve; ii) rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore përfshirë agjenci të tjera ligjzbatuese, sidomos për veprat penale “Krijimit të skemave mashtruese me tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”; iii) delegimin e dosjeve të referuara nga Drejtoria e Hetimit Tatimor/Drejtoria e Përgjithshme të Doganave tek oficerët e policisë gjyqësore që kryejnë referimet përkatëse; iv) zhvillimin e trajnimeve të burimeve njerëzore për teknikat speciale të hetimit për hetimet komplekse financiare, për veprat penale në fushën e trafikimit dhe ndryshimet ligjore dhe procedurale; v) rritje e vëmendjes dhe ashpërsim të politikës së dënimit në lidhje me sekuestrimin e aseteve ose të ardhurave që rrjedhin nga veprat penale të evazionit fiskal ose skemave mashtruese me TVSH-në; vi) oficerët e policisë gjyqësore të doganave të jenë pjesë e njësisë të posaçme të krijuara pranë prokurorive të rretheve; vii) në lidhje me veprat penale të lojërave të fatit, sugjerohet forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe i shkëmbimit të të dhënave në lidhje me subjektet që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë (lojërat e fatit); viii) është i nevojshëm një trajtim i unifikuar sipas një metodologjie për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale në aspektin penal por dhe në fushën e veprimtarisë së ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, sidomos në kushtet aktuale kur kompetenca hetimore për të dyja aspektet u përket prokurorive të rretheve gjyqësore.

Ministria e Mbrojtjes vlerëson bashkëpunimin ndërinstitucional me prokurorinë lidhur me veprat penale të referuara gjatë fazës së hetimeve të këtyre veprave.

Në kuadër të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional, rekomandohet: i) vazhdimi i bashkëpunimit midis Policisë Ushtarake dhe prokurorisë, sidomos për veprat penale që lidhen me detyrën të cilat ndikojnë në uljen e operacionalitetit dhe realizimin e detyrave nga Forcat e Armatosura; ii) informimi nga ana e prokurorisë në lidhje me ecurinë e procedimeve dhe vendimet përfundimtare të çështjeve penale në ngarkim të ushtarakëve; iii) zhvillimin e hetimeve proaktive, si dhe përdorimin e metodave speciale të hetimit.

Sa më sipër, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Rritjen e bashkëpunimit me policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm të grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, në fushën e krimit të organizuar dhe, kryesisht grupet kriminale të trafikimit të narkotikëve, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimit kundër korrupsionit dhe atij financiar, sekuestrimin e aseteve kriminale;

ii) Forcimin e bashkëpunimit me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të hetimeve proaktive që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave, pastrimit të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe terrorizmit;

iii) Forcimin e bashkëpunimit me oficerët e policive gjyqësore të të gjitha agjencive ligjzbatuese me

<sup>64</sup> Me shkresën e tyre nr. 2404/7, datë 29.3.2018 ku është përcjellë kontributi në fushën e tatimeve, fushën e doganave dhe shkresa nr. 143/1, datë 23.2.2018 e DPPP-së.

qëllim udhëheqjen, mbikëqyrjen, kryerjen e analizave periodike për evidentimin e praktikave të mira dhe problematikave, në funksion të rritjes së cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe dokumentimit të tyre;

iv) Rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore<sup>65</sup>, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre;

v) Trajnime të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtim të teknikave speciale dhe hetimeve komplekse që kryhen për hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, krimeve financiare, evazionit fiskal dhe veprave penale ushtarake;

vi) Forcimi i bashkëpunimit në funksion të hetimeve të shpejta dhe forcimit të masave ndëshkuese nga prokuroria për veprat penale në fushën e mjedisit, me qëllim shmangien e katastrofave mjedisore dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit;

vii) Forcimi i bashkëpunimit në funksion të rritjes së efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal, por edhe nëpunësve publikë të administratës tatimore.

viii) Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet drejtorive përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme me qëllim shkëmbimin në kohë reale të informacionit, përmirësimin e cilësisë së akteve dhe shpejtësisë së kryerjes së veprimeve procedurale, në kuadër të ekzekutimit të ekstradimeve dhe letërporosive, në mënyrë të veçantë për çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

ix) Forcimi të koordinimit ndërinstitucional për të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, krimeve financiare, evazionit fiskal.

x) Forcimi i bashkëpunimit me autoritet gjyqësor dhe agjencitë ligjzbatuese të huaja dhe vendëse në drejtim të përmirësimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

---

<sup>65</sup> Oficerët e policisë gjyqësore së Ministrisë së Financave (hetimit tatimor, doganave), Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Brendshme.